REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 339-346/19
Datë/Datum. 15.07.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e Prokurimit: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor OE ankues: - "Nika Pro-ing & Bejta Comerce" sh.a dhe - "EL-Bau" sh.p.k	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP 339,346/19
Prej:	Es'heme Beka – Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me Nr. **339,346/19** të parashtruar nga OE "Nika Pro-ing & Bejta Comerce" sh.a – Ferizaj dhe OE OE " EL-Bau" SH.P.K-Gjilan		
Datë	**15.07.2019**		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e datës: 24.06.2019, me nr. 339/19 të parashtruar nga OE "Nika Pro-ing & Bejta Comerce" sh.a - Ferizaj, dhe ankesën e datës 26.06.2019 me nr. 346/19 të parashtruar nga OE " EL-Bau" SH.P.K-Gjilan lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Rregullimi-pastrimi i lumit Hogosht deri te ura e Domarocit-Ranillug"**, me numër të prokurimit: **210/19/1666/5-1-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues – "Nika Pro-ing & Bejta Comerce" sh.a – Ferizaj dhe.
- OE ankues – "EL-Bau"SH.P.K - Gjilan

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

	01.07.2019	**15.07.2019**
Nënshkrimi i ekspertit	*data e autorizimit të ekspertit.*	*data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

- Me datën: 24.06.2019, OE "Nika Pro-ing & Bejta Comerce" sh.a - Ferizaj, dhe me daten 26.06.2019, OE "EL-Bau" SH.P.K ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit mbi vendimin e AK-së ku është rekomanduar për kontratë Grupi i OE "Arbor Group sh,p,k & Teuta-M SH.P.K - Kamenicë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Rregullimi-pastrimi i lumit Hogosht deri te ura e Domarocit-Ranillug** me nr. të prokurimit: **210/19/1666/5-1-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Operatori Ekonomik Ankues "Nika Pro-ing & Bejta Comerce" sh.a - Ferizaj,.

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues "Nika Pro-ing & Bejta Commerce" sh.a – Ferizaj, janë:

Neni 1 – Qëllimi
Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;
Neni 60 – Kriteret për dhënie të kontratës;

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues "EL-Bau" SH.P.K - Gjilan, janë:

OE ankues "El Bau" në cilësinë e palës së interesuar që mund të dëshmojë interes material nga rezultati përfundimtar i këtij aktiviteti të prokurimit konsideron se me rastin e udhëheqjes së procedurës të vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve si dhe vendosjes në lidhje të njëjtin AK ka vepruar në shkelje të parimeve bazike dhe parimeve kryesore të procedurës së vlerësimit duke mos aplikuar drejt dhe shkelur dispozitat qenësore të

LPP-së si në vijim:

1) **Neni 1- Qëllimi** , për arsye se nuk është arritur Qëllimi i këtij ligji i cili është të siguroj mënyrën me efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike,burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke marrë në konsideratë qëllimin, lëndën e prokurimit duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.
2) **Neni 7- Barazia në trajtim/Jo-DISKRIMINIMI-** për arsye se AK nuk i trajton të gjithë OE në mënyrë të barabartë duke zbatuar parimin e mos-diskriminimit që për rrjedhojë eliminohet konkurrenca e lirë dhe e drejtë, OE fitues favorizohet edhe përkundër faktit se ka dorëzuar tender të papërgjegjshëm që nuk i plotëson kërkesat e përzgjedhjes ndërsa në anën tjetër OE ankues diskriminohet duke u eliminuar me arsyetime të cilat nuk përbëjnë vlerësim të drejtë të gjendjes faktike. Po ashtu në këtë aktivitet janë vendosur kritere diskriminuese në kundërshtim me par.3 dhe par.6 pika (iii) me kërkesa të specifikuara (janë kërkuar licenca) që janë në kundërshtim me objektin (titullit) të lëndës me qëllim të favorizimit të OE fitues dhe përjashtuar OE tjerë.

3) **Neni 52 par.7- (Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës)** – për arsye se OE i rekomanduar për dhënien e kontratës në dosjen e tenderit në mënyrë të qëllimtë ka dorëzuar dëshmi të palexueshme (librezat e pajisjeve teknike) që janë ekuivalente me një letër të bardhë pa kurrfarë fuqie provuese dhe validiteti dhe është e çuditshme se si AK ju ka falur besimin dokumenteve të padukshme –palexuara që nuk dihet se qfarë përmbajtje ka në to.

4) **Neni 56 par.1.1 dhe 1.2 dhe par. 3** - Dispozitat i e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave – neni 26. i RRUOPP (Kriteret e përzgjedhjes) – e para për arsye se OE i shpallur fitues nuk ka plotësuar kërkesat e kualifikimit (përzgjedhjes) të specikuara në nenin 9.1&9.2 lidhur me kapacitetin teknik (kamionët dhe pajisjet tjera) siç janë kërkuar në njoftim të kontratës dhe në dosjen e tenderit ngase dëshmitë që i ka ofruar (kopjet e librezave) janë të palexueshme, padukshme ,nuk vërehen fare të dhënat se cilën pajisje e dëshmojnë,kush është pronar i pajisjes, nuk vërehet validiteti i regjistrimit, etj. Dhe për më tepër të njëjtat pajisje që i ka huazuar me marrëveshje nga OE "Bejta Comerce" janë përdorur në këtë aktivitet edhe nga vet tenderuesi OE "Bejta Comerce" E dyta i njëjti ka dorëzuar tender me çmime manipulative që në terme ligjore klasifikohen si tender jo-normalisht i ulët (shih pozicionin 4.6, pozicionin 4.7), e që AK kundrejt të njëjtit nuk ka aplikuar dispozitat përkatëse nga neni 61 të LPP-së dhe rregullat – rregulloren për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët. E treta,lidhur me arsyen për eliminim te OE ankues që e ka dhënë në pikën e parë (1),AK na diskualifikon mbi bazën e një kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe dosjen e tenderit (në pikën 9.2 lidhur me pikën 9.1 të FTD-së nuk është kërkuar fare ndonjë dëshmi (licencë apo marrëveshje) lidhur me produktet e betonit – pllakat terraco.

5) **Neni 59 par.2 dhe 4 i LPP-së dhe neni 41.3 i RrUOPP –Ekzaminimi, Vlerësimi dhe krahasimi i Tenderëve** - për arsye se vlerësimi është udhëhequr në kundërshtim me parimin e barazisë dhe mos diskriminimit,parimin e ligjshmërisë (legjislacionit të aplikueshëm material për prokurimin publik – lyp-së dhe akteve nënligjore në zbatim), parimin e efikasitetit /efektivitetit (parimit të ruajtjes së vlerës për para) që ka rezultuar me një vendimmarrje e padrejtë e të paligjshme mbi bazën e vërtetimit të gabueshëm të gjendjes faktike. Vendimi i ak-së ka një përfundim të padrejtë dhe paligjshëm ngase faktet që do t'i parashtrojmë të mbështetura në prova dhe ligj dëshmojnë se kundrejt OE ankues -nuk ekziston asnjëra arsye që është përdorur nga AK për eliminim dhe në anën tjetër se OE i rekomanduar për kontratë nuk i

plotëson të gjitha apo kërkesat minimale të përzgjedhjes siç jan kërkuar në dosjen e tenderit si dhe oferta e tij financiare në shumë pozicione përmban çmime manipulative respektivisht tender jo-normalisht të ulët.

6) **Neni 60 –Kriteret për dhënien e kontratës** – për arsye se OE ankues përkundër iu është mohuar dhënia e kontratës si tenderuesi i përgjegjshëm me çmim më të ulët në bazë të gjendjes faktike dhe nga një rivlerësim i drejtë dhe i ligjshëm do të provohet se ka dorëzuar tender të përgjegjshëm (ka plotësuar të gjitha kriteret e përzgjedhjes) që plotëson kriterin e kontratës.

   Ndërsa në anën tjetër provat argumentojnë se grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk i ka përmbushur kërkesat as minimale të kualifikimit që hyn tek kërkesat e përzgjedhjes të cilat nga AK janë specifikuar në njoftimin për kontratë dhe dosjes së tenderit në kuptim të nenit 56 paragrafi 1.1. të LPP-së, andaj i njëjti nuk është dashur mos të kalojë fare në vlerësimin e kriterit për dhënien e kontratës(çmimit më të lirë) sipas kritereve të vendosura në nenin 60 paragrafi 1.1 të LPP-së, që është kusht i detyrueshëm ligjor.

7) **Neni 69 – Aftësia teknike dhe/ose profesionale** – e para për arsye se kundrejt OE ankues "El Bau" ,AK në arsyetimin e përgjithshëm të dhënë për eliminim në pikën dy (2) pa specifikuar se cilat pajisje apo dëshmi mungojnë ka nxjerrë vlerësim të gabueshëm dhe jo të saktë të gjendjes faktike. OE ankues ka ofruar dëshmitë përkatëse që dëshmon se e plotëson në tërësi këtë kërkesë të AK-së siç edhe kërkohet me nenin 69 par.6.3 të LPP-së. E dyta OE e rekomanduar për dhënien e kontratës bazuar në dëshmitë e ofruara (libreza,DUD-at, etj) të cilat janë tërësisht të padukshme (palexueshme) ku nuk dihet se cilën pajisje e dëshmojnë, kush është pronari, a kanë validitet regjistrimi, nuk e plotëson kërkesën e nenit 9.2 lidhur me nenin 9.1 të kapacitetit teknik –pajisjeve teknike për realizimin e projektit në fjalë.

8) **Neni 72 i LPP-së dhe neni 39 dhe 41.7 i RRUOPP- Dokumentacioni dhe informacioni shtesë** – e para për arsye se OE i rekomanduar për kontratë lidhur me kërkesën e vendosur në dosjen e tenderit pika 9.2 lidhur me pikën 9.1 të FTD-së sa i përket kapacitetit teknik –pajisjeve teknike ka dorëzuar dëshmi të palexueshme (librezat e pajisjeve teknike) që nuk dihet se çfarë përmbajtjesh kanë që janë ekuivalente me një letër të bardhë pa kurrfarë fuqie provuese dhe validiteti . AK ka pasur detyrim ligjor të mos ju falë besimin këtyre dokumenteve pa asnjë fuqi provuese/ dëshmuese por të bëj një kontroll efektiv të këtyre dokumenteve dhe të kërkoj nga OE fitues informacione dhe sqarime shtesë;

9) **Neni 26.4 (Kriteret e përzgjedhjes) i Rregullave dhe Udhëzuesit të Prokurimit Publik-** për arsye se AK ka obligim ligjor që gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtojë rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike.

Në rastin konkret AK duke i krijuar kushte favorizuese OE fitues dhe përdorur kritere diskriminuese kundrejt OE tjerë në kundërshtim me nenin 7 e ka shkelur këtë dispozitë me vendosjen e kërkesave lidhur me licencën për prodhim tregtim dhe import të bimëve dekorative që është në kundërshtim me objektin e lëndës/ titullit të kontratës dhe vendoset vetëm për një pozicion (3.11 në vlerë të përafërt 3,000.00€) dhe aludimit në kërkesën për licencë me shenjën CE për produktin pllaka terraco.

10) **Neni 4.4 i rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për prokurimin Publik.** Të gjitha aktivitetet e

prokurimit do të udhëhiqen në pajtim me parimet bazike si në vijim: konkurrenca- në mesin e furnizuesve duhet të inkurajohet në mënyrën me efikase dhe me efektive ; Efikasiteti & Efektiviteti-duhet të dëshmohet në procesin e prokurimit për të siguruar vlerën për paranë për AK; Drejtësia/Mos-diskriminimi – Të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për furnizuesit, ose furnizuesit potencial. Të shmanget çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial; Llogaridhënie – Të ketë llogaridhënie për përgjegjësitë e përcaktuara, si dhe për vendimet e nxjerra, dhe regjistrimin e të dhënave të nevojshme; Profesionalizëm – Të punohet me standarde të larta profesionale duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe duke aplikuar praktikat më të mira.

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET: "Nika Pro-ing & Bejta Comerce" sh.a - Ferizaj.

+Ne jemi njoftuar me letër standarde për tenderues të pasuksesshëm në projektin e lartpërmendur ku jemi njoft për pikat qe nuk i kemi plotësuar kërkesë sipas FTD-së:

Ne pretendimin 1. E kundërshtojmë për arsye që në FTD ceket shumë qartë se OE të siguroj AK-në për materialet e përdorura të jenë sipas kërkesës, mirëpo nuk është kërkesë e AK-së që të sjellë në këtë fazë certifikatën EN-13748-2 & ISO 9001:2015, citojmë kërkesën e AK-së:

Operatori ekonomik te siguroj Autoritetin Kontraktues se materialet e pozicionit ku përdoren pllakat terraco me EC (Declaration of Conformity). Produkti te posedoj shenjen CE ne përputhje me direktivat per CPD (Construction Product Directive) dhe EN 13748-2, ashtu qe duhet te posedojnë ateste te certifikuara me shenjen CE nga prodhuesi i cili duhet te jete i certifikuar sipas ISO 9001 2015 (Sistemi për menaxhimin e cilësisë) për sistem hermetik te makinerisë prodhuese, për artikullin e kërkuara sipas pozicionit Pllaka terastone njështresore nga graniti dhe mermeri me granit natyral (Graniti, Diabaz, Bazalt).

Ne këtë kërkesë e kemi plotësuar me deklarata ku kemi cekur se ne do të ofrojmë produkte sipas kërkesës së AK-së.

Ne pretendimin 2. E kundërshtojmë për arsye ku ceket se na mungojnë dy kamioneta-min 2 copa & pompa e ujit 2 copa.
Ne listën e makinerisë te "Bejta Comerc" janë të dëshmuara edhe nga ana e noterit EN minutes se këto makineri edhe tjerat e më shumë jan të dëshmuara se jan në pronësi te OE "Bejta Comerc "nga Gjilani , duhet të cekim se në listën e makinerisë shkruan cisternë (është e njëjta) jan në deshmi librezat dhe fotografit që e dëshmojnë që OE Bejta Comerc posedon dy cisterna /pompa të ujit, njashtu në listën e mekanizmit është bërë një gabim teknik të shënimet e kamionëve jan edhe dy kamioneta me libreza dhe të dëshmuara me procedurën EN –minutes.

Ne pretendimin 3. E kundërshtojmë për arsye se në listën e stafit të OE" Nika Pro-ing" është ne liste inxhinieri z. Bashkim Hasani i cili plotëson kërkesën e AK –së ku të njëjtin e kemi punëtor të rregullt në kompani // këtë pretendim AK-ja gjatë kërkesës për ri-shqyrtim e ka pranuar se e kan gabuar.

Në pikën shtesë ku AK-ja në kundërshtim më LPP-në ka vepruar ka, konstatuar se na mungojnë licenca nga ministria e bujqësisë për prodhim , tregtim dhe import të bimëve dekorative , pasi qe marrëveshja e

bashkëpunimit me z Naim Maliqin për plotësimin e kërkesës së AK-së edhe nuk cekët në kërkesën FTD-së që OE Lider duhet ti këtë këto licenca , pasi qe natyra e punës është ndërtimore e jo bujqësore. Edhe duhet të cekemi së AK-ja këtë kriter e ka vendosur në kundërshtim më LPP-në pasi qe në paramasën e këtij projekti nuk është për të mbjellurë asnjë bimë, apo drunj dekorativ. Ne e kemi plotësuar këtë kriter pasi që në marrëveshjen tonë të noterizuar e kemi cekur se furnizimet i bën kompania e licencuar.
Duhet të cekët se OE i rekomanduar për kontratë nuk është i përgjegjshëm pasi nuk plotëson kriterin për punë të ngjashme 750.000,00 ku në raste konzerciumi lideri duhet të ketë 60% të vlerës së kontratës.

- Ne përgjigjeje e AK-së së ky pretendim nuk qëndron pasi qe tek ky kriter nuk është kërkuar që në rast konzerciumi lideri duhet të këtë 60% të vlerës së kërkuar.
- Ne ofrojmë kërkesën në FTD të AK-së:

Operatori ekonomik duhet t'i ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i Operatorit Ekonomik , gjatë tre viteve të fundit deri në njoftimin për kontratë ka qenë gjithsej min. 900,000.00 Euro. Në rast të konzerciumi, lideri duhet t'i plotësoj 60% të vlerës së kërkuar.
Dëshmia e kërkuara
Vërtetim nga ndonjë banke e licencuar e Kosovës qe dëshmon se qarkullimi i OE gjate tri viteve te fundit deri ne njoftimin për kontrate ka qene minimumi 900,000.00 euro.

Përfundimisht ekzaminimi , vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe një kohësishtë nuk është respektuar edhe kriteri kryesorë për dhënie të kontratës e qe ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, sipas nenit 60 të LPP-së.

Pas analizës dhe vërejtjes së lëshimit teknik rezulton se edhe neni 1 dhe neni 6 nuk jan respektuar , sepse dihet se qëllimi i LPP-së të sigurohet mënyra më efikase, me transparente dhe më e drejt e shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Kërkojmë nga OSHP-ja lënda e këtij projekti të kthehet në ri-vlerësim kërkojmë të na shpalleni neve fitues të këtij tenderi, sepse i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET: GO "EL-Bau"SH.P.K Gjilan

AK-MMPH përmes letrës standarde për tenderuesin e eliminuar OE " EL-Bau"SH.P.K të dt. 06.06.2019 ,ka konstatuar se jemi eliminuar për arsyet si në vijim.

1. **Tek kapaciteti teknik dhe profesional, OE tek pozicioni ku përdoren pllakat tarraco me CE, ne këto produkte mungojnë Atestet, siç është kërkuar;**
2. **Tek kapaciteti teknik dhe profesional, OE tek pajisjet makinerike mungojnë libreza dhe DUD nuk i ka të dëshmuara siç është kërkuar;**
3. **Si dhe çmimit më të lartë me krahasim me OE fitues**

Ndërsa në bazë te vendimit Nr. Prot. 3777/19 të dt. 17/06/2019 me të cilin është Refuzuar si e pabazë kërkesa për Rishqyrtimin e parashtruar në emër të OE ankues "El Bau" Sh.p.k, AK nuk paraqet asnjë arsye që përfshijnë shpjegimet faktike dhe ligjore për tu përgjigjur lidhur me pretendimet ankimore që ankuesi i ka

parashtruar kundrejt arsyeve të eliminimit. Me këtë vendim i cili në tërësi ka karakter përshkrues me formulim të përgjithshëm dhe abstrakt. AK i anashkalon arsyet që vet i kishte dhënë në letrën standarde për eliminimin e OE ankues dhe në kundërthënie me vetë veten e nxjerr një arsyetim tjetër, të ri, gjoja se na mungon Licenca nga Ministria e Bujqësisë për prodhim, tregtim dhe importim të bimëve dekorative me justifikimin se gjoja se nuk ka qenë kërkesë që ky kriter të plotësohet me marrëveshje bashkëpunimi.

Pretendimi Ankimor Nr.1 – lidhur me arsyet e eliminimit OE "El Bau"

Arsyetimet që janë përdorur për eliminimin e OE ankues në pikëpamje të gjendjes të drejtë faktike **JANË TË QËNDROJNË** pasi që OE ankues ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për të plotësuar të gjitha kërkesat e përzgjedhjes siç janë specifikuar në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë. AK gjatë vlerësimit të ofertave nuk iu është përmbajtur zbatimit të drejtë dhe të ligjshëm të dispozitave ligjore, qenësore të LPP-së. Andaj si rrjedhojë vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 par .4 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar neni 60 i LPP-së, kriteri kryesor për dhënien e kontratës që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët. Po ashtu AK nuk ka respektuar edhe të gjitha dispozitat bazike të LPP-së që lidhen me parimet e prokurimit dhe atë duke filluar nga shkeljet e nenit 1,nenit,6 neni 7, neni 52 par. 7, nenit 56 par .1.1.1.2 dhe 1.3 nenit 69,nenit 72 të LPP-së dhe nenit 4.4 dhe 26.4 të RRUOPP.

ARSYETIMI I PARË i AK-së ku konstatohet se **"Tek kapaciteti teknik dhe profesional ,OE tek pozicioni ku përdoren pllakat terraco me CE, ne këto produktet mungon Atestet, siç është kërkuar ,NUK QËNDRON** bazuar në faktet dhe argumentet e pasqyruara si në vijim:

Në kërkesën e vendosur nenin 9.2 të FTD-së lidhur me kërkesën 9.1 të FTD-së sa i përket produktit të pllakave terraso që thuhet të posedojnë shenjen CE dhe EN 13748-2 i certifikuar sipas ISO 9001 2015, **NUK ËSHTË KËRKUAR asnjë dëshmi dokumentare duke përfshirë por pa u kufizuar ne Marrëveshje me prodhuesin, Licencë për prodhimet e betonit-pllakave tarraco me CE,** por që shprehimisht është përshkruar kërkesa si në pikën 9.1 siç po e parafrazoj; **"OE të siguroj** AK se materialet e pozicionit ku përdoren pllakat tarraco me EC (Declaration of Conformity). Produkti ta posedoj shenjen CE në përputhje me direktivat për CPD (Construction Product Directive) dhe EN 13748-2 ashtu që duhet të posedojë teste të certifikuara me shenjen CE nga prodhuesi i cili duhet të jetë i certifikuar sipas ISO 9001 2015 (Sistemi për menaxhimin e cilësisë)"

Dispozita e nenit 56 par. 3 Në mënyrë shumë të qartë përcakton se ; "Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit." Në rastin konkret OE ankues është eliminuar mbi bazën e një kërkese /kriteri që nuk është cekur në DT dhe NJK.

Kërkesa e AK-së është qe materiali/produkti në fjalë duhet të posedojë teste të certifikuara me shenjen CE nga prodhuesi i cili duhet të jetë i certifikuar sipas ISO 9001 2015 (sistemi për menaxhimin e cilësisë". OE ankues e plotëson në tërësi kërkesën në fjalë ngase i ka në posedim certifikatat specifike të kërkuara nga AK siç e vërtetojnë dëshmitë që ju bashkëngjisim. AK për ta sqaruar këtë çështje varësisht nga rasti është dashur që të veproj në përputhje me nenin 59.2 nenin 72 të LPP-së dhe nenit 39.8 të RRUOPP (tabela me shembujt që nuk janë te vetmet raste) ku shprehimisht përcaktohet se si të veproj në kësi raste AK dhe në rastin konkret nëse mungon çertifikata ISO është dashur që të kërkohen informata sqaruese .**(Provë shih certifikatat në fjalë)**

Pra në rastin konkret,AK i ka injoruar kërkesat ligjore të LPP-së dhe me qëllim të krijimit të favoreve për OE fitues e ka diskualifikuar OE ankues mbi bazën e një kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në dosjen e tenderit dhe që përbën shkelje ligjore në kuptim të nenit 56 par.3 të LPP-së.

ARSYETIMI I DYTË i AK-së ku konstatohet se ***Tek kapaciteti teknik dhe profesional ,OE Tek kapaciteti teknik dhe profesional tek pajisjet makinerike mungojnë libreza dhe DUD nuk i ka të dëshmuara siç është kërkuar "NUK QËNDRON"*** bazuar në faktet dhe argumentet e pasqyruara si në vijim:

Ky arsyetim i përdoruar për eliminim është tërësisht i paqëndrueshëm dhe konsiderojmë se është dhënë vetëm si shkas për diskualifikim të OE ankues me qëllim të favoreve në orientimin e kontratës tek OE i rekomanduar për kontratë. Arsyetimi është abstrakt dhe i përgjithshëm, nuk është dhënë një arsyetim konkret se për cilën pajisje bëhet fjalë që mungojnë librezat apo DUD-at. E vërteta është se OE ankues e ka plotësuar në tërësi kërkesën e vendosur nga AK lidhur me kapacitetin teknik gjegjësisht për mjetet e punës (makineritë) të vendosur në nenin 9.1 &9.2 të FTD-së nga AK. Këtë gjendje faktike e vërtetojnë dëshmitë dokumentare që janë pjesë e dosjes së tenderit për secilën pajisje që OE ankues e ka në pronësi/ posedim.

Arsyetimi i dhenë në pikën 3 dëshmon se AK nuk është në gjendje të dalloj kriteret e përzgjedhjes me kriterin për dhënien e kontratës. Nga ky arsyetim kuptojmë se AK krahasimin e ofertave ne mes OE fitues dhe OE ankues e ka bërë në bazë të lartësisë së çmimit të ofertuar. Dhe nuk është bazuar në 4 fazat e vlerësimit bazuar në parimin e procedurës se vlerësimit siç përcaktohet në nenin 41.3 te RRUOPP-së dhe LPP-së.

ARSYETIMI SHTESË në bazë të vendimit nr. prot. 3777/19 të dt.17/06/2019 me të cilin është Refuzuar si pa bazë kërkesa për Rishqyrtim e parashtruar në emër të OE ankues "El Bau Sh.p.k", **NUK QËNDRON** për shkak se:

Rregullat ligjore të LPP-së e përkatësisht të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve lejojnë palët që të lidhin marrëveshje të çfarëdo natyre në rastin konkret bashkëpunimi sipas vullnetit të tyre të lirë për ta plotësuar njëri-tjetrin në plotësimin e ndonjë kërkese të caktuar apo të veçantë të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Po ashtu bazuar në parimet e përgjithshme të prokurimit sipas LPP-së dhe rregullave të përgjithshme të prokurimit OE-ve nuk mund të ju kufizohet kur ata e konsiderojnë të nevojshme që me OE të caktuar që posedojnë kapacitetin e nevojshëm dhe janë të licencuar siç është rasti konkret për tenderin në fjalë për një pozicion të caktuar për plotësimin e kërkesës lidhur me licencën në fjalë,të lidhin marrëveshje bashkëpunimi,të krijojnë konzerciumi bashkëpunimi,të nënkontraktojnë punën deri në 40% të vlerës së kontratës. Ne tenderin e cekur objekt i kontratës është rregullimi dhe pastrimi i lumit Hogosht deri te ura në Gjilan që përbën 99.5% të kontratës, nuk ka të bëjë fare me bimë dekorative në krejt lëndën është vetëm një pozicion 3.11 andaj kufizimi i konkurrencës sipas logjikës së AK-së përmes licencës të cekur nga Ministria e Bujqësisë vetëm nga OE ofertues pa e lënë mundësinë e marrëveshjes do t'i mundësonte vetëm OE-ve të caktuar që të shpërblehen me kontratë. Si rrjedhojë AK nuk mund që t'i injoroj kërkesat ligjore të LPP-së dhe ligjeve të veçanta që rregullojnë fushën e krijimit të marrëdhënieve juridike,sepse me kësi lloj kërkese si në rastin konkret janë krijuar favore haptazi për OE të caktuar apo në të kundërtën diskriminimin për OE të caktuar.

Prandaj për kundrejt faktit se lënda e kësaj kontrate në 99.5% është rregullimi dhe pastrimi i lumit të caktuar dhe në krejt lëndën e këtij aktiviteti është vetëm një pozicion dhe atë pozicioni 3.11 që ka të bëj lidhur me këtë produkt që në vlerë monetare përbën afërsisht 3,000.00€ nga vlera e parashikuar e projektit që është

700,000,00€,në kërkesën në fjalë rreth licencës nuk kufizohet marrëveshja me ndonjë OE që e ka këtë licencë siç aludon AK. Në këtë kuptim OE ankues e ka siguruar këtë licencë përmes lidhjes së një marrëveshje të bashkëpunimit me një OE të caktuar, andaj edhe e plotëson në tërësi këtë kërkesë e cila në tërësi është kërkesë favorizuese për OE të caktuar dhe në anën tjetër diskriminuese për OE të caktuar.

Nga krejt faktet dhe argumentet që i pasqyruam në këtë pretendim ankimor,konsiderojmë se oferta e ankuesit nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim dhe se kundrejt OE ankues vlerësimi i tenderit është bërë në kundërshtim me nenin 59 par .4 të LPP-së, njëkohësisht nuk është respektuar kriteri për dhënien e kontratës që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët konform nenit 60 par. 1.1 të LPP-së. Si rrjedhojë janë shkelur edhe dispozitat ligjore duke filluar nga neni 1,neni 6, neni 7 par. 1,2,4, 6 pika (iii), (iv),neni52 par. 7,neni 56 par. 1.;1.2 dhe 1.3 neni 69 par. 6.3 , neni 72, neni 108/A par. 12 të LPP-së si dhe dispozitat e RRUOPP duke filluar nga neni 4.4 neni 26.4, neni 39,neni 41.3 dhe 41.7.

Po të trajtoheshin në mënyrë të barabartë me OE konkurrent- fituesin, në mënyrë të ligjshme dhe të drejtë bazë të kritereve të kërkuara ligjore do të shpalleshim fitues si tenderuesi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Pretendimi Ankimor 2 lidhur me vendimin e AK-së për dhënien e kontratës "Arbnor Group & Teuta M"

Bazuar në dëshmitë qe i kemi i vërejtur gjatë qasjes zyrtare në dosjen e dorëzuar nga OE fitues, kemi vërejtur se i njëjti nuk i ka plotësuar kërkesat e kualifikimit (përzgjedhjes) përkatësisht kërkesat e kapacitetit teknik të kërkuara ne nenin 9.1& 9.2 lidhur me kapacitetin teknik.
Po ashtu kemi vërejtur se OE në fjalë ka dorëzuar tender me çmime manipulative qe ne terme ligjore klasifikohen tender jo-normalisht i ulet (shih pozicionin 3.1 , pozicionin 4.6) e qe AK kundrejt të njëjtit nuk ka aplikuar dispozitat përkatëse nga neni 61 të LPP-së dhe Rregullat - Rregulloren për tenderin jo-normalisht të ulët fakte mbi të cilat bazohet ky pretendim janë:

Arsyeja e parë:

OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk e ka plotësuar kërkesën nga neni 9.2 të FTD-së lidhur më kapacitetin teknik mjetet e punës për shkak se dëshmitë të cilat i ka ofruar (librezat e qarkullimit dhe DUD-at) në tërësi janë të palexueshme, nuk iu dihet përmbajtja dhe si të tilla nuk kanë ndonjë fuqi provuese /dëshmuese , janë ekuivalente me një dokument si letër e bardhë .nga këto dokumente nuk dihet përshkrimi se për çfarë pajisje bëhet fjalë, nuk dihet se kush është pronari i pajisjes, nuk dihet validiteti i regjistrimit etj Nuk e kemi të qartë se si është vlerësuar dosja e OE fitues me kapacitetin teknik ku sipas dëshmive të dorëzuara nuk vërehen shënimet e nevojshme nga të cilat mund të identifikohet pajisja, pronësia kapaciteti i saj, validiteti i regjistrimit etj .Andaj shtrohet pyetja se në cilat të dhëna është bazuar AK kur ka vlerësuar se OE fitues e plotëson kapacitetin teknik sipas kërkesave të AK-së ku në dokumentet e ofruara nuk vërehen të dhënat bazike dhe të nevojshme për identifikim dhe vlerësim.

Pra vet ky fakt tregon se AK nuk e ka bërë vlerësimin mbi bazën e gjendjes faktike dhe mbështetjen ligjore dhe se këtu qëndron qëllimi për të favorizuar OE në fjalë ngase e ka vlerësuar si tender të përgjegjshëm pa e ditur se çfarë pajisje i njëjti ka ofruar për ta plotësuar kapacitetin teknik të kërkuar ne nenin 9.2&9.1 të FTD-së së dosjes se tenderit . Dhe për me tepër të njëjtat pajisje qe i ka huazuar me marrëveshje nga OE Bejta Comerce" janë përdorur në këtë aktivitet edhe nga vet tenderuesi OE " Bejta Commerce".
Për më tepër i bashkangjesim edhe kopje e këtyre dëshmive dokumentare te OE fitues i ka dorëzuar në dosjen e tenderit te cilave nuk iu vërehen shënimet që të vlerësohet pajisja se a e plotëson apo nuk e plotëson

kërkesën e DT-së.

Arsyeja e dytë:

E dyta nga qasja zyrtare kemi vërejtur se OE i rekomanduar për kontratë ka dërguar tender me çmim manipulativ qe në terme ligjore klasifikohet si tender jo-normalisht i ulet dhe atë për pozicionet si ne vijim:

- **Te pozicioni 3.1 furnizimi, transport dhe vendosja e thasëve me rërë (secutex Soft Rock R601) ose të ngjashme për stabilizimin e skarpateve,sipas detalit të projektit** ka ofruar çmim manipulativ në vlerë prej 5 eurove për m^3 qe bije në kundërshtim me pozicionet 2.6,2.7,4.3,4.4 dhe 4.8 , ku për këto pozicione ka ofruar çmim prej 14 eurove për m^3 nga një analizë e logjikshme krahasuese nxirret ne pah fakti se OE në fjalë me çmime manipuluese ka vënë në lajthim Autoritetin AK – , për faktin se OE fitues "Arbor Group" ShPK " Teuta-M" SHPK nga Koretini Kamenicë, për një m^3 zhavor të cilën e sjell me kamion ofron me çmim prej 14 euro, ndërsa për një m^3 zhavor që duhet ta vendos ne thasë e cila kap kosto shumë më te lartë ofron një çmim për 5 euro.

- Pozicioni 4.7 Furnizimi me material dhe montimi i Places nga llamarina e galvalizuar me trashësi të fletës prej 4 mm, ndërsa gjerësia e saj duhet të jetë min. 50 cm (1000x500x4), e mbështetur në shtyllat e vendosura në të dyja anët si mbështetje e drejtimit te shtegut Për këtë pozicion për 1 kg ka ofruar një çmim prej 0.40 cent, që i bie se me këtë çmim nuk mund që të bëj vetëm shërbimin e montimit e në asnjë mënyrë furnizimin e saj, dhe ky çmim bie ne kundërshtim edhe me:

- Pozicionin 4,6 Furnizimi me material dhe montimi i shtyllave te çelikut te galvanizuar dhe me dimensione te 50x50x4mm, ne pozicionet e përcaktuara sipas projektit. Shtyllat duhet te jenë te ngulitura ne bazamentin prej guri te thyer te nevojshme per mbështetjen e llamarinës kufizuese te shtegut, ku për këtë pozicion ka ofruar çmimin 1,10 euro, pasi që dy pozicionet janë me material të njëjtë.

AK kundrejt të njëjtit nuk ka aplikuar dispozitat përkatëse nga neni 61 të LPP-së dhe rregullat - Rregulloren për tenderët Jo –Normalisht të Ulët që i propozojmë t' i aplikojë gjatë ri-vlerësimit.

Nga krejt faktet dhe argumentet që i pasqyruam në këtë pretendim ankimor, konsiderojmë se oferta e OE fitues nuk i plotëson kriteret e përzgjedhjes lidhur me kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional (pajisjet/mjetet), në pozicione të caktuara siç u pasqyruan ka dorëzuar çmime manipuluese , dhe si e tillë AK ka pasur detyrim ligjor që ta refuzojë si tender i papërgjegjshëm dhe mos të kalojë fare në fazën e fundit në vlerësimin e kriterit për dhënien e kontratës.

Pretendimi Ankimor 3 lidhur me dyshimin për vendosjen e kritereve favorizuese për OE fitues dhe diskriminuese për OE tjerë dhe në kundërshtim me objektin e lëndës.

Konsiderojmë se kriteret e vendosura lidhur me **Licencat nga ministria e Bujqësisë për Prodhim,tregtim dhe import te bimëve dekorative,** janë kritere që i janë përgatitur dhe përshtatur OE "Arbnor Group" dhe për më tepër dyshojmë se këto kritere janë sjellë apo rekomanduar në AK nga vet OE në fjalë me qëllim të eliminimit të konkurrencës kundrejt OE të tjerë. Dihet se ky OE fitues posedon këtë licencë, ndërsa për projektin dhe të vetmin pozicion 3.11 Furnizimi, transporti dhe mbjellja e shtresës vegjetative me t=20cm, sipas detalit të projektit,nuk është e domosdoshme posedimi i licencës, për këtë i bie se është përgatitur dhe përshtatur me kritere qysh nga fillimi i hartimit dhe shpalljes së këtij aktiviteti të prokurimit.

Lënda e kësaj kontrate është "rregullimi,pastrimi lumit..." pra objekti i lëndës nuk ka fare të bëj me bimë dekorative. Në krejt lëndën e këtij aktiviteti është vetëm një pozicion dhe atë pozicioni 3.11 që ka të bëj lidhur me këtë produkt që në vlerë monetare përbën afërsisht 3,000.00€ e ndërsa krejt vlera e parashikuar e projektit është 700,000.00€ .

Në nenin 51 (njoftimi i Kritereve të përzgjedhjes) paragrafi 3 thuhet: *Të gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse.*

Shtrohet pyetja se a është relevante dhe proporcionale në raport ne lëndën e kontratës kjo licencë e kërkuar nga AK në një kontratë ku vlera e parashikuar është 700,000.00€ dhe për këtë produkt ka vetëm një pozicion që nuk përbën as min. E përqindjes së kontratës.

Pra faktet vërtetojnë se AK në këtë aktivitet ka vendosur kritere diskriminuese në kundërshtim me par.3 dhe par. 6 pika (iii) dhe (iv) të nenit 7 të LPP-së me kërkesa të specifikuara (licenca) që janë në kundërshtim me objektin (titullit) e lëndës me qëllim të favorizimit të OE fitues dhe përjashtuar OE tjerë dhe në kundërshtim me nenin 51 par. 3 të LPP-së.

Në bazë të nenit 26.4 (kriteret e Përzgjedhjes) i Rregullave dhe Udhëzuesit të Prokurimit Publik AK ka Obligim ligjor që gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim,AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ ose teknike.

Pretendimi Ankimor 4 lidhur me shkeljen e Nenit 108/A paragrafi 12 –Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve i LPP-së – Neni 8.2 i rregullave për paraqitje të kërkesave për rishqyrtim pranë AK-së.

Me këtë vendim AK nuk ka eliminuar asnjërën nga shkeljet e cekura në pretendimet ankimore të parashtruara nga ankuesi në kërkesën për rishqyrtim. AK nuk ka shqyrtuar asnjërin nga pretendimet ankimore dhe nuk ka analizuar, shqyrtuar dhe administruar faktet dhe provat materiale të cilat janë pasqyruar në ankesë. Përkundrazi ky vendim i cili është i përshkruar në mënyrë abstrakte dhe te përgjithshme është në kundërthënie me vet letrën standarde për tenderuesin ne eliminuar- ankuesin. Nga vet vendimi vërehet se AK duke mos ndërmarrë masa korrigjuese ka pasur qëllimin që të ngelet pranë rezultatit të njëjtë i cili nuk është i bazuar dhe nxjerr mbi vlerësime të drejta dhe të ligjshme. Ky vendim është në kundërshtim edhe me Ligjin e Përgjithshëm të Procedurës Administrative të nenit 48 (arsyetimi i një akti administrativ) ngase ne vendim nuk është dhënë asnjë arsyetim që: shpjegon situatën faktike mbi të cilën është marrë vendimi, shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, shkaqet për të cilat nuk janë pranuar pretendimet ankimore, shpjegimin e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

KONKLUZION

Bazuar në rrethanat faktike që u pasqyruan në këtë ankesë, konsiderojmë se AK me veprimet saj në nxjerrjen e vendimeve të paligjshme dhe të padrejta në kundërshtim me parimet bazike dhe parimet kryesore të procedurës së vlerësimit i ka shkelur dispozitat qenësore dhe procedurale, legjislacionit të prokurimit të cilat janë specifikuar më lartë.
Me shkeljen e nenit 1 nuk është arritur Qëllimi i këtij ligji i cili është të siguroj mënyrën më efikase, më

transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike,burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke marrë në konsideratë qëllimin,lëndën e prokurimit duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

Ndërsa me shkeljen e nenit 7 të LPP-së, eliminohet konkurrenca e lirë dhe e drejtë në mes OE-ve. OE fitues favorizohet edhe përkundër faktit se ka dorëzuar tender të papërgjegjshëm që nuk i plotëson kërkesat e përzgjedhjes ndërsa në anën tjetër OE ankues diskriminohet duke u eliminuar me arsyetime të cilat nuk përbëjnë vlerësim të drejtë të gjendjes faktike. Po ashtu kjo dispozitë është shkelur edhe për shkak se në këtë aktivitet janë vendosur kritere diskriminuese në kundërshtim me par. 3 dhe par. 6 pika (iii) me kërkesa të specifikuara (janë kërkuar licenca) që janë në kundërshtim me objektin (titullit) e lëndës me qëllim të favorizimit të OE fitues dhe përjashtuar OE tjerë.

----------perfundim i pretendimeve ankimore----------

Andaj kërkohet që pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe provave të paraqitura, Organi Shqyrtues i Prokurimit të merr:

V E N D I M

I. **APROVOHET** si e bazuar ANKESA e Grupi i OE "EL BAU" SH.P.K..

II. **ANULOHET Vendimi i** AK-së i Nr. Prot. 3777/19 i dt.17.06.2019 me të cilin është **Refuzuar si e pa bazë** Kërkesa për rishqyrtim e parashtruar në emër të OE ankues "El Bau SH.P.K " si dhe në anën tjetër është vërtetuar dhe lënë në fuqi vendimi i atakuar për dhënien e kontratës OE "Damastion Project Sh.p. k.& Via Egnatia Sh.p.k .& Urban" për lot 2, i Dt.14.05.2019

III. **ANULOHET** Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënien e kontratës OE "Arbnor Group" Sh.p.k. &K.N.T.SH "Teuta-M" Sh.p.k . i dt.06.06.2019;

IV. **ANULOHET** Letra standarde për tenderuesin e Eliminuar, grupin e OE "El Bau", i dt 06.06.2019 dhe lënda të Ri-vlerësohet duke marrë masa korrigjuese për ta rregulluar aktivitetin e prokurimit në pajtueshmëri me këtë ligj.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë.....01.04.2019

Lloji i procedurës së aplikuar.....Procedurë e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar....., Punë

Vlera e parashikuar e kontratës.....700,000.00

Kriteri për dhënie të kontratës.....tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave.....10.05.2019

Data e hapjes së ofertave.....10.05.2019

Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave.....05.06.2019

Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të eliminuar.....06.06.2019

Data e vendimit të AK-së për dhënie të kontratës.....06.06.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim " Nika pro-ing& Bejta Commerce".....10.06.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim " EL-BAU SH.P.K".....10.06.2019

Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim" Nika pro-ing& Bejta Commerce.....14.06.2019

Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim "EL- BAU"SH.P.K.....17.06.2019

Kriteret për vlerësim

III.2)KUSHTET PËR PJESËMARRJE

Përshtatshmëria profesionale: 1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit 2.Regjistrimi i TVSH; 3.Certifikata e numrit fiskal – kopje	***Dëshmia e kërkuar dokumentare:*** Certifikata e regjistrimit te biznesit – kopje Certifikata e TVSH – kopje Certifikata e numrit fiskal – kopje Nëse ne Certifikatën e Regjistrimit te biznesit është i shënuar edhe numri fiskal atëherë Certifikata e Regjistrimit te Biznesit shërben edhe si dëshmi e Certifikatës
Kapaciteti ekonomik dhe financiar: Operatori ekonomik duhet t'i ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i Operatorit Ekonomik , gjatë tre viteve të fundit deri në njoftimin për kontratë ka qenë gjithsej min. 900,000.00 Euro. Në rast të konzorciumit, lideri duhet t'i plotësoj 60% të vlerës së kërkuar.	***Dëshmia e kërkuar dokumentare:*** Vertetim nga ndonje banke e licensuar e Kosoves qe deshmon se qarkullimi i OE gjate tri viteve te fundit deri ne njoftimin per kontrate ka qene minimumi 900,000.00 euro
Kapaciteti teknik dhe professional: Operatori ekonomik te siguroj Autoritetin Kontratkues se materialet e pozicionit ku	***Dëshmia e kërkuar dokumentare*** Operatori ekonomik te siguroj Autoriteti Kontratkues se materialet e pozicionit k

perdoren pllakat terraco me EC (Declaration of Conformity). Produkti te posedoj shenjen CE ne perputhje me direktivat per CPD (Construction Product Directive) dhe EN 13748-2, ashtu qe duhet te posedojne ateste te çertifikuara me shenjen CE nga proshuesi i cili duhet te jete i çertifikuar sipas ISO 9001 2015 (Sistemi per menaxhimin e cilesise) per sistem hermetik te makinerise prodhuese, per artikullin e kerkuara sipas pozicionit Pllaka terastone njeshtresore nga graniti dhe mermeri me granil natyral (Graniti, Diabaz, Bazalt).	perdoren pllakat terraco me EC Declaration of Conformity). Produkti ı posedoj shenjen CE ne perputhje m direktivat per CPD (Construction Produ Directive) dhe EN 13748-2, ashtu qe duh te posedojne ateste te çertifikuara m shenjen CE nga proshuesi i cili duhet ı jete i çertifikuar sipas ISO 9001 201 (Sistemi per menaxhimin e cilesise) pe sistem hermetik te makinerise prodhues per artikullin e kerkuara sipas pozicion Pllaka terastone njeshtresore nga grani dhe mermeri me granil natyral (Granit Diabaz, Bazalt).
Operatori ekonomik duhet te ofroj deshmi se gjate tri viteve te fundit deri ne njoftimin per kontrate ka kryer me sukses pune të natyrës së ngjajshme. Vlera e puneve te kryera duhet te jete minimumi 750,000.00 euro	Operatori ekonomik duhet te ofroje listen e kontratave të ngjajshme të realizuara gjatë tri viteve të fundit deri në njoftimin per kontrate. E deshmuar me kopjen e referencave ose procesverbalet e pranimit përfundimtar të punëve duke treguar vlerën , datën, natyrën dhe vendodhjen e projekteve dhe vendodhjen e projekteve të punëve në lëmin e kërkuar.(vlera e puneve te perfunduar duhet te jete minimum 750,000.00 euro) Lista duhet te dorezohet ne origjinal e nenshkruar dhe vulosur nga operatori ekonomik.
Operatori ekonomik duhet te ofroje deshmi se ka staf minimumi 20 punetor te profilit qe lidhen me kete lemi te projektit.	E deshmuar me Liste nga ATK-ja.
Nje (1) inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master min 3 vite përvojë pune pas diplomimit. Nje (1) inxhinier i diplomuar i bujqësisë ose master min 3 vite përvojë pune pas diplomimit.	Dëshmi diploma kopje (e noterizuar), CV dhe kontrata e punës. Nëse është i angazhuar vetëm për këtë kontratë duhet ta prezentoj edhe marreveshjen e bashkepunimit (të noterizuar).
Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose posedim pajisje teknike për realizim të suksesshëm të kontratës Bager 24 - 30 ton - minimumi 2 copë Kamiona 3 dhe 4 aksa - minimumi 3 copë Bazë të betonit Autopompe betoni - minimumi 1 copë Automikser betoni - minimumi 3 copë Cisternë per ujitje me	Lista e paisjeve e vërtetuar nga Operatori Ekonomik dhe e noterizuar me procedure EN minutes. Listës së paisjeve t'i bashkangjiten këto deshmi kopje të librezave mbi pronësinë e tyre, ose DUD-i doganor, ose fatura e blerjes. Makineria e cila mirret në huazim, ti bashkangjitet edhe marreveshjen e

kapacitet 9000 L - Minimum 2 copë Bullduzher me kapacitet min 45 ton - minimumi 1 copë Lopate ngarkuese minimumi 29 ton - minimumi 1 copë Cilinder per ngjeshje minimumi 12 ton - minimumi 1 copë Kamionet - min 2 copë Pompa uji - min 2 copë	bashkëpunimit-huazimit-qeramarrjes (të noterizuar)
Licencat nga Ministria e Bujqesise per Prodhim, tregtim dhe import te bimeve dekorative	Dëshmi Licencat nga Ministria e Bujqesise per Prodhim, tregtim dhe import te bimeve dekorative (kopje e noterizuar)

:

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatorët ekonomik	Vendi	Çmimi/€	Vërejtje
1.	"VARNA SH.P.K;NNT KOSOVA ERH & KOTORI SH.P.K.; FIDANISHTJA PARKU SH.P.K	Kamenicë	615.964,13	
2.	"EL-BAU" SH.P.K LIMON STANECI	Gjilan	685.974,12	
3.	"EUROFAMES" SH.A.	Shirokë	690.132,32	
4.	"ARBOR GROUP SH.P.K; K.N.T.SH Teuta –M sh.p.k	Kamenicë	636.394,65	
5.	Infra-Plus SH.P.K	Prishtinë	671.381,06	
6.	NIKA PrO-Ing SH.P.K COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A.	Ferizaj	616.286,39	

Komisioni vlerësues pranë AK:

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- Fidan Bilalli– Kryetar i komisionit
- Severgjan Radonqiq– Anëtar i komisionit
- Mevlane Kukaj– Anëtar i komisionit

Raporti i komisionit vlerësues:

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Gjatë fazës se vlerësimit komisioni ka konstatuar se kishin gjithësej 6 OE, ku vetëm njeri prej tyre i plotëson

kushtet sipas njoftimit për kontratë dhe dosje të tenderit, andaj, komisioni rekomandon për dhënie të kontratës OE, Grupin e Operatoreve Ekonomik "ARBOR GROUP SH.P.K; K.N.T.SH Teuta –M sh.p.k me çmimin e ofruar prej 636,394,65

OE që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm sipas komisionit vlerësues:

Nr.	Emri i operatorëve ekonomik që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm	Vendi	Çmimi
1.	"ARBOR GROUP SH.P.K; K.N.T.SH Teuta –M sh.p.k	**Kamenic**	636394,65 €

Komisioni pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, ka ardh në përfundim se OE ofertues "ARBOR GROUP "SH.P.K, është i përgjegjshëm dhe të njëjtin e kanë rekomanduar për kontratë, me çmim prej: 636394,65 €
Rekomandimi i komisionit vlerësues është aprovuar nga Menaxheri i prokurimit.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "Nika Pro-ing & Bejt Commerc"sh.a - **Ferizaj.**

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Pretendimi i parë ankimor është se OE "Nika Pro-ing & Bejt Commerc" është njoftuar me letër standarde për tenderues të pasuksesshëm në projektin e lartpërmendur ku jemi njoftuar për pikat qe nuk i kemi plotësuar kërkesë sipas FTD-së:

Ne pretendimin1. E kundërshtojmë për arsye që në FTD ceket shumë qartë se OE të siguroj AK-në për materialet e përdorura të jenë sipas kërkesës, mirëpo nuk është kërkesë e AK-së që të sjellë në këtë fazë certifikatën EN-13748-2 & ISO 9001:2015,

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesat e AK –së nuk ka qenë të qarta ku kërkesat e vendosura ne DT tek kapaciteti teknik dhe profesional jan të njëjta me dëshmitë e kërkuara dokumentare. Kërkesat e AK ne dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë janë:

Kapaciteti teknik dhe professional:	***Dëshmia e kërkuar dokumentare***

Operatori ekonomik te siguroj Autoritetin Kontratkues se materialet e pozicionit ku perdoren pllakat terraco me EC (Declaration of Conformity). Produkti te posedoj shenjen CE ne perputhje me direktivat per CPD (Construction Product Directive) dhe EN 13748-2, ashtu qe duhet te posedojne ateste te çertifikuara me shenjen CE nga proshuesi i cili duhet te jete i çertifikuar sipas ISO 9001 2015 (Sistemi per menaxhimin e cilesise) per sistem hermetik te makinerise prodhuese, per artikullin e kerkuara sipas pozicionit Pllaka terastone njeshtresore nga graniti dhe mermeri me granil natyral (Graniti, Diabaz, Bazalt).	Operatori ekonomik te siguroj Autoritetin Kontratkues se materialet e pozicionit ku perdoren pllakat terraco me EC (Declaration of Conformity). Produkti te posedoj shenjen CE ne perputhje me direktivat per CPD (Construction Product Directive) dhe EN 13748-2, ashtu qe duhet te posedojne ateste te çertifikuara me shenjen CE nga proshuesi i cili duhet te jete i çertifikuar sipas ISO 9001 2015 (Sistemi per menaxhimin e cilesise) per sistem hermetik te makinerise prodhuese, per artikullin e kerkuara sipas pozicionit Pllaka terastone njeshtresore nga graniti dhe mermeri me granil natyral (Graniti, Diabaz, Bazalt).

Sa i përket kësaj pike OE ankues ka pasur te drejë të kërkoj sqarim nga AK-ës duke u bazuar tek pika 16.1 e FTD Sqarimi i Dosjes së Tenderit deri me dt. 18.04.2019. Ndërsa sa i përket plotësimit të kësaj kërkese eksperti shqyrtues sqaron se në ofertën e juaj është e bashkangjitur një deklaratë ku keni cekur se do të ofroni pllaka tarraco me EC dhe të certifikuara me ISO standarde të kërkuar. Andaj duke pasur parasysh kërkesat e paqarta të AK-së për dëshmitë dokumentare në këtë pikë dhe sqarimet që u dhanë me lartë del se ky pretendim ankimor është **pjesërisht i bazuar.**

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Pretendimi tjetër i OE ankues është se jemi eliminuar për arsye ku ceket se na mungojnë dy kamioneta-min 2 copa & pompa e ujit 2 copa. Ne listën e makinerisë te "Bejta Commerc" janë të dëshmuara edhe nga ana e noterit EN minutes se këto makineri edhe tjerat e më shumë jan të dëshmuara se jan në pronësi te OE "Bejta Commerc "nga Gjilani

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në kërkesat e AK –së dhe dokumentacionit të bashkangjitur në ofertë konstaton se kërkesë e AK-së ka qenë:

Lista e pajisjeve e vërtetuar nga Operatori Ekonomik dhe e noterizuar me procedure EN minutes. Listës së pajisjeve t'i bashkëngjiten këto dëshmi kopje të librezave mbi pronësinë e tyre, ose DUD-i doganor, ose fatura e blerjes. Makineria e cila merret në huazim, ti bashkëngjitet edhe marrëveshjen e bashkëpunimit-huazimit-qiramarrjes (të noterizuar).

Prandaj eksperti shqyrtues sqaron se ne dokumentacionin e bashkangjitur ne ofertën e Grupi i OE "Pro-ing dhe Bejta Comerce" ku Lista e pajisjeve e vërtetuar nga Operatori Ekonomik dhe e noterizuar me procedure EN minutes është e bashkangjitur në ofertë, në këtë listë figurojnë 2 kamion cisterne ku kanë të bashkangjitur librezat mbi pronësinë e tyre ku plotëson kërkesën e AK-së.
Ndersa sa i përket kamionetave në ankesën e bere nuk është sqaruar se çfar gabimi teknik është bere tek shënimi i kamioneve . Prandaj nga kjo qe u tha me lartë eksperti shqyrtues konstaton se ky kundërshtim është i pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.3

Ne pretendimin 3. E kundërshtojmë për arsye se në listën e stafit të OE Nika Pro-ing është ne liste inxhinieri z. Bashkim Hasani i cili plotëson kërkesën e AK –së ku të njëjtin e kemi punëtor të rregullt në kompani // këtë pretendim AK-ja gjatë kërkesës për ri-shqyrtim e ka pranuar se e kan gabuar.
Eksperti shqyrtues konstaton se inxhinieri Bashkim Hasani plotëson kërkesën e AK-së dhe kjo pik është vërtetuar edhe nga AK-ja në përgjigjeje e kërkesës për ri-shqyrtim .

Përgjigje në Pretendimi nr.4

Pretendimi tjetër i OE ankues është se AK-ja në kundërshtim më LPP-në ka vepruar ka konstatuar se na mungojnë licenca nga ministria e bujqësisë për prodhim , tregtim dhe import të bimëve dekorative , pasi qe marrëveshja e bashkëpunimit me z Naim Maliqin nuk vlen për plotësimin e kërkesës së AK-së .Ne e kemi plotësuar këtë kriter pasi që në marrëveshjen tonë të noterizuar e kemi cekur se furnizimet i bën kompania e licencuare.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne kërkesat e AK-së dhe dokumentacionin në lëndë konstaton se kërkesë e AK-së ka qene:
Dëshmi Licencat nga Ministria e Bujqësisë për Prodhim, tregtim dhe import te bimëve dekorative (kopje e noterizuar) .
Prandaj eksperti shqyrtues sqaron se kjo marrëveshje nuk mund te konsiderohet e vlefshme pasi qe nuk ka qen kërkesë e AK-së qe të plotësohet me ndonjë marrëveshje bashkëpunimi. Prandaj nga kjo qe u tha me lart del qe ky pretendim ankimor **është i pa bazuar.**

Përgjigje në Pretendimi nr.5

Pretendimi tjetër i OE ankues është se për Licencat nga Ministria e Bujqësisë për Prodhim AK-ja këtë kriter e ka vendosur në kundërshtim më LPP-në pasi qe në paramasën e këtij projekti nuk është për të mbjellurë asnjë bimë, apo drunj dekorativ.
Sa i përket këtij pretendimi eksperti shqyrtues sqaron se OE duke u bazuar ne nenin 108/A paragrafi 1 dhe 3.1 të LPP-së OE ankues ka pasur te drejt të paraqes kërkesë për rishqyrtim pran AK-së ne këto raste deri ne afatin kohor te përcaktuar me neni 108/A ku thotë:

1. *Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlidhen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.*

   1.3. Në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave;

   Prandaj duke u bazuar ne sqarimet me lart eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor **nuk qendron.**

Përgjigje në Pretendimi nr.6

Pretendimi tjetër i OE ankues është se OE i rekomanduar për kontratë nuk është i përgjegjshëm pasi nuk plotëson kriterin për punë të ngjashme 750.000,00 ku në raste konzerciumi lideri duhet të ketë 60% të vlerës së kontratës.

Ekspert shqyrtues sqaron se kërkesë e AK –së në këtë pikë në dosjen e tenderit ka qenë:

Operatori ekonomik duhet te ofroj dëshmi se gjate tri viteve te fundit deri ne njoftimin për kontrate ka kryer me sukses pune të natyrës së ngjashme. Vlera e punëve te kryera duhet te jete minimumi 750,000.00 euro.

Prandaj duke u bazuar ne kërkesat e AK-së eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim nuk qëndron pasi qe tek ky kriter nuk është kërkuar që në raste konzerciumi lideri duhet të këtë 60% të vlerës së kërkuar dhe si i tillë ky pretendim është i pa **bazuar.**

++++

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË GRUPIT TË OE ANKUES "EL-Bau "sh.p.k - **Gjilan.**

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Pretendimi i parë i OE ankues është se në kërkesën e vendosur nenin 9.2 nuk është kërkuar asnjë dëshmi dokumentare duke përfshirë por pa u kufizuar ne Marrëveshje me prodhuesin, Licencë për prodhimet e betonit-pllakave tarraco me CE, por që shprehimisht është përshkruar kërkesa si në pikën 9.1

Poashtu Kërkesa e AK-së është qe materiali/produkti në fjalë duhet të posedojë teste të certifikuara me shenjen CE nga prodhuesi i cili duhet të jetë i certifikuar sipas ISO 9001 2015 (sistemi për menaxhimin e cilësisë". OE ankues e plotëson në tërësi kërkesën në fjalë ngase i ka në posedim certifikatat specifike të kërkuara nga AK siç e vërtetojnë dëshmitë që ju bashkëngjisim.

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesat e AK –së nuk ka qenë të qarta ku kërkesat e vendosura ne DT tek kapaciteti teknik dhe profesional jan të njëjta me deshmit e kërkuara dokumentare. Kërkesat e AK ne dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontrat janë:

Kapaciteti teknik dhe professional:	***Dëshmia e kërkuar dokumentare***
Operatori ekonomik te siguroj Autoritetin Kontratkues se materialet e pozicionit ku perdoren pllakat terraco me EC (Declaration of Conformity). Produkti te posedoj shenjen CE ne perputhje me direktivat per CPD (Construction Product Directive) dhe EN 13748-2, ashtu qe duhet te posedojne ateste te çertifikuara me shenjen CE nga proshuesi i cili duhet te jete i çertifikuar sipas ISO 9001 2015 (Sistemi per menaxhimin e cilesise) per sistem hermetik te makinerise prodhuese, per artikullin e kerkuara sipas pozicionit Pllaka terastone	Operatori ekonomik te siguroj Autoritetin Kontratkues se materialet e pozicionit ku perdoren pllakat terraco me EC (Declaration of Conformity). Produkti te posedoj shenjen CE ne perputhje me direktivat per CPD (Construction Product Directive) dhe EN 13748-2, ashtu qe duhet te posedojne ateste te çertifikuara me shenjen CE nga proshuesi i cili duhet te jete i çertifikuar sipas ISO 9001 2015 (Sistemi per menaxhimin e cilesise) per sistem hermetik te makinerise prodhuese, per artikullin e kerkuara sipas pozicionit Pllaka terastone

njështresore nga graniti dhe mermeri me granil natyral (Graniti, Diabaz, Bazalt).	njështresore nga graniti dhe mermeri me granil natyral (Graniti, Diabaz, Bazalt).

Sa i përket kësaj pike OE ankues ka pasur te drejtë të kërkoj sqarim nga AK-ës duke u bazuar tek pika 16.1 e FTD Sqarimi i Dosjes së Tenderit deri me dt. 18.04.2019. Ndërsa sa i përket plotësimit të kësaj kërkese eksperti shqyrtues sqaron se në ofertën e juaj është e bashkangjitur një deklaratë ku keni cekur se do të ofroni ateste sipas kërkesës se AK-së për pozicionet të cilat jan ne paramasë. Andaj duke pasur parasysh kërkesat e paqarta të AK-së për deshmit dokumentare në këtë pikë dhe sqarimet që u dhanë me lartë del se ky pretendim ankimor është **pjesërisht i bazuar.**

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Pretendimi tjetër i OE ankues është se AK-së konstaton se ***Tek kapaciteti teknik dhe profesional tek pajisjet makinerike mungojnë libreza dhe DUD nuk i ka të dëshmuara siç është kërkuar "NUK QËNDRON"*** nuk është dhënë një arsyetim konkret se për cilën pajisje bëhet fjalë që mungojnë librezat apo DUD-at.
Eksperti shqyrtues konstaton ne ofertën e OE ankues është e bashkangjitur lista e makinerisë dhe AK-ja është dashur të cek qartë se për cilat makineri mungojnë dëshmitë e kërkuara në dosjen e tenderit. Prandaj nga sqarimet më lart del se ky pretendim **ankimor qendron.**

Përgjigje në Pretendimi nr.3

Pretendimi tjeter i OE ankues është se AK ka kufizuar OE kur ata e konsiderojnë të nevojshme që me OE të caktuar që posedojnë kapacitetin e nevojshëm dhe janë të licencuar siç është rasti konkret për tenderin në fjalë për një pozicion të caktuar për plotësimin e kërkesës lidhur me licencën në fjalë,të lidhin marrëveshje bashkëpunimi, të krijojnë konzerciumi bashkëpunimi,të nënkontraktojnë punën deri në 40% të vlerës së kontratës duke mos lejuar marrëveshje bashkëpunimi .
Ne tenderin e cekur objekt i kontratës është rregullimi dhe pastrimi i lumit Hogosht deri te ura në Gjilan që përbën 99.5% të kontratës, nuk ka të bëjë fare me bimë dekorative në krejt lëndën është vetëm një pozicion 3.11 andaj kufizimi i konkurrencës sipas logjikës së AK-së përmes licencës të cekur nga Ministria e Bujqësisë vetëm nga OE ofertues pa e lënë mundësinë e marrëveshjes do t'i mundësonte vetëm OE-ve të caktuar që të shpërblehen me kontratë.

Eksperti shqyrtues sa i përket këtij pretendimi duke u bazuar ne nenin 108/A të LPP-së konstaton se paragrafi 1 dhe 1.3 i këtij neni thot:

2. *Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlidhen me njoftimet për kontratë,* ***dokumentet e tenderit,*** *ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.*

   3.1 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave;

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues sa i përket kësaj pike është dashur të paraqes kërkesë për rishqyrtim pran AK-ës ne lidhej me dokumentet e tenderit brenda pesë ditëve para afatit për dorëzim te ofertave. Dhe si i tillë ky pretendim në këtë fazë të këtij aktivitetit të prokurimit **nuk qëndron.**

Përgjigje në Pretendimi nr.4

Pretendimi tjetër i OE ankues është se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk e ka plotësuar kërkesën nga neni 9.2 të FTD-së lidhur më kapacitetin teknik mjetet e punës për shkak se dëshmitë të cilat i ka ofruar (librezat e qarkullimit dhe DUD-at) në tërësi janë të palexueshme, nuk iu dihet përmbajtja dhe si të tilla nuk kanë ndonjë fuqi provuese /dëshmuese , janë ekuivalente me një dokument si letër e bardhë . Dhe për me tepër të njëjtat pajisje qe i ka huazuar me marrëveshje nga OE Bejta Comerce" janë përdorur në këtë aktivitet edhe nga vet tenderuesi OE " Bejta Commerce".
Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne dokumentacionin në lëndë konstaton se ne ofertën e OE "Arbor sh.p.k për listën e pajisjeve dëshmitë të cilat i ka ofruar (librezat e qarkullimit dhe DUD-at) disa nga to jan te palexueshme poshtu disa makineri të cilat i ka huazuar me marrëveshje nga OE Bejta comerce" janë të njëjta që do ti përdorur në këtë aktivitet edhe nga vet tenderuesi OE " Bejta Commerce".Prandaj nga sqarimet që u dhanë me lartë del qe ky pretendim ankimor **është i bazuar.**

Përgjigje në Pretendimi nr.5

Pretendimi tjetër i OE ankues është se OE i rekomanduar për kontratë ka sjellë çmime ab-normalisht të ulët ne pozicionet 3.1, 4.6 dhe 4.7.
Eksperti shqyrtues ne vazhdim ka llogaritur në mënyrë te detajuar çmimin për pozicionet në fjalë.

Nr.	Lot 1			
	A	B	C	D
1	kushti 1 - është përmbushur kushti i pare sepse janë pranuar 6 oferta	Pranuar 6 oferta		
1	EL-Bau	POZICIONI 3.1	98,385.00	
2	"ARBORN GROUP"	POZICIONI 3.1	81,519.00	
3	VARNA sh.p.k	POZICIONI 3.1	91,357.50	
4	NIKA PRO-ING sh.p.	POZICIONI 3.1	70,275.00	
5	EUROFAMIS Sh.a	POZICIONI 3.1	98,385.00	
6	INFRA PLUS sh.p.k	POZICIONI 3.1	63,242.50	
8		Total (C2+C3+C4+C5+C6+C7)	503,164.00	
9		mesatarja (C8/6)	83,860.66	
10	kushti 2 - te gjitha ofertat nen ketë	pragu 30% (mesatarja /1.3)	64,508.2	ne ketë rast oferta e OE "ARBOR SH.P.K.

	çmim përmbushin kushtin e dyte			**nuk** përmbush kushtin e dyte prandaj **NUK vazhdohet me kushtin e trete**

Kushti	Kërkesa	Arsyetimi
1	Janë pranuar me shume se **3 oferta**	Është plotësuar kushti i pare sepse janë pranuar 6 oferta.
2	Çmimi i ofruar është më shumë se **30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve** të përgjegjshëm	Oferta e OE "Arbor grup" sh.p.k nuk plotëson kushtin e dyte (30%) sepse çmimi i ofruar është me pak se 30% me i ulet se mesatarja e tenderëve. Shih pragun ne kolonën C10
Konkludim	**oferte e OE "Arbor Group" nuk mund te konsiderohet si oferte abnormalisht e ulet sipas paragrafit 3.1**	

Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne rregullat për tenderin ab-normalisht të ulët dhe në llogaritjet për pozicion konstaton se oferta e OE te rekomanduar për kontratë tek pozicioni 3.1 nuk mund te konsiderohet si pozicion ab-normalisht e ulet. Prandaj nga sqarimet me lartë del se ky pretendim ankimor **është i pa bazuar.**

Llogaritja për pozicionin 4.6

Nr.	Lot 1			
	A	B	C	D
1	**kushti 1** - është përmbushur kushti i pare sepse janë pranuar 6 oferta	**Pranuar 6 oferta**		
1	"EL-Bau" sh.p.k	POZICIONI 4.6	10,080.00	
2	"ARBOR GROUP"	POZICIONI 4.6	**10,560.00**	
3	VARNA sh,p,k	POZICIONI 4.6	28,800.00	
4	"NIKA PRO-ING"sh.p.k	POZICIONI 4.6	12,480.00	
5	"EUROFAMIS" Sh.a	POZICIONI 4.6	9,600.00	
6	"INFRA PLUS" SH.P.K	POZICIONI 4.6	14,400.00	
8		**Total (C2+C3+C4+C5+C6+C7)**	**85,920.00**	
9		**mesatarja (C8/6)**	**14,320.00**	
10	**kushti 2** - te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dyte	**pragu 30% (mesatarja /1.3)**	**11,015.38**	ne ketë rast oferta e OE "Arbor Group" sh.p.k përmbush kushtin e dyte prandaj vazhdohet me kushtin e trete

		(C2+C3+C4+C5+C6+C7)		
9		mesatarja (C8/6)	17,733.33	
10	kushti 2 - te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dyte	pragu 30% (mesatarja /1.3)	13,641.02	ne ketë rast oferta e OE Arbor sh.p.k përmbush kushtin e dyte prandaj vazhdohet me kushtin e trete
11	kushti 3 – pragu 10% ne mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dyte me te lire	pragu 10% (oferta e dyte /1.1)	7,272.72	ne ketë rast oferta OE Arbor sh.p.k përmbush edhe kushtin e trete

Kushti	Kërkesa	Arsyetimi
1	Janë pranuar me shume se **3 oferta**	Është plotësuar kushti i pare sepse janë pranuar 6 oferta
2	Çmimi i ofruar është më shumë se **30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve** të përgjegjshëm	Oferta e dyte plotëson kushtin e dyte (30%) sepse çmimi i ofruar është me shume se 30% me i ulet se mesatarja e tenderëve. Shih pragun ne kolonën C10
3	Çmimi i ofruar është më shumë se **10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët**	Oferta e dyte plotëson edhe kushtin e trete (10%) sepse ne krahasim me ofertën e dyte me radhe është me shume se 10% me i ulet. Shih pragun C11
Konkludim	**Oferta me nr. rendor 2 plotëson 3 kushtet e përcaktuara dhe si rrjedhoje mund te konsiderohet si oferte abnormalisht e ulet**	

Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne llogaritjet për pozicion konstaton se oferta e OE te rekomanduar për kontratë tek pozicioni 4.7 konsiderohet si pozicion ab-normal e ulët. Po ashtu eksperti shqyrtues sqaron se AK-ës duke u bazuar ne rregulloren për çmimin ab-normalisht të ulet është dashur të kërkoj nga OE i rekomanduar për kontratë sqarime në lidhje me këtë pozicion .Prandaj nga sqarimet me lartë del se ky pretendim ankimor **është i bazuar.**

Përgjigje në Pretendimi nr.6

Pretendimi tjetër Ankimor është lidhur me dyshimin për vendosjen e kritereve favorizuese për OE fitues dhe diskriminuese për OE tjerë dhe në kundërshtim me objektin e lëndës.
Konsiderojmë se kriteret e vendosura lidhur me **Licencat nga ministria e Bujqësisë për Prodhim,tregtim dhe import te bimëve dekorative,** janë kritere që i janë përgatitur dhe përshtatur OE "Arbor Group" dhe për më tepër dyshojmë se këto kritere janë sjellë apo rekomanduar në AK nga vet OE në fjalë me qëllim të eliminimit të konkurrencës kundrejt OE të tjerë. Dihet se ky OE fitues posedon këtë licencë, ndërsa për projektin dhe të vetmin pozicion 3.11 Furnizimi, transporti dhe mbjellja e shtresës vegjetative me t=20cm, sipas detalit të projektit,nuk është e domosdoshme posedimi i licencës, për këtë i bie se është përgatitur dhe

përshtatur me kritere qysh nga fillimi i hartimit dhe shpalljes së këtij aktiviteti të prokurimit.

Eksperti shqyrtues sa i përket këtij pretendimi duke u bazuar ne nenin 108/A të LPP-së konstaton se paragrafi 1 dhe 1.3 i këtij neni thot:

3. *Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlidhen me njoftimet për kontratë,* ***dokumentet e tenderit,*** *ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.*

   3.2 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave;

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues sa i përket kësaj pike është dashur të paraqes kërkesë për rishqyrtim pran AK-ës ne lidhej me dokumentet e tenderit brenda pesë ditëve para afatit për dorëzim te ofertave. Dhe si i tillë ky pretendim në këtë fazë të këtij aktivitetit të prokurimit **nuk qëndron.**

Përgjigje në Pretendimi nr.7

Pretendimi tjetër i OE ankues është se AK nuk ka shqyrtuar asnjërin nga pretendimet ankimore dhe nuk ka analizuar, shqyrtuar dhe administruar faktet dhe provat materiale të cilat janë pasqyruar në ankesë.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar nenin 108/A te LPP-në paragrafi 12, ku thot:

12. Kundërshtimet dhe vendimet e miratuara në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni, duhet të jenë të arsyetuara dhe ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë.

Poashtu duke u bazuar në sqarimet më lart eksperti shqyrtues sqaron se AK-ës është dashur te jap përgjigjej në te gjitha pretendimet ankimore te OE ankues dhe ti arsyetoj ato. Prandaj nga kjo qe u tha me lar del se ky pretendim ankimor **është i bazuar**

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues të aprovohen pjesërisht si të bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet **në rivlerësim.**